



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me nr.12-3395/1 të datës 02.07.2019, , **NDËRPRITET**, për arsye se pretendimet nuk janë vërtetuar.

KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-3395 të vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12-3395/1 të datës 20.07.2019 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për sjellje të pakujdesshme dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe kompetencave të një zyrtari në shkollën e mesme komunale /// nga ///. Siç tregohet në aplikim, në shkollën fillore të përmendur më sipër, në vendin e punës pedagog, në kohë të pacaktuar, pas një konkursi publik të shpallur më parë, është punësuar personi ///, me diplomë në gjuhën frënge në R. Bullgarisë, pa një certifikatë të nestrukturimit të diplomës së saj të arsimit të lartë të përfunduar jashtë vendit. personi në fjalë nuk i plotësonte kushtet për punësim për nga lloji i arsimit të lartë, duke qenë se ka diplomuar në gjuhën frënge dhe jashtë vendit, dhe jo me fakultet të kryer mësimor, d.m.th. fakulteti i filozofisë, drejtimit pedagogjik. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së dhe nga përgjigja e marrë nga ana e tij, konstatoi se pretendimet e paraqitura në denoncim janë plotësisht të pabazuara. Përkatësisht, personi i cekur në denoncim ka kryer arsimin e lartë në R. Bullgarisë – fitoi titullin profesional mësues i diplomuar, profesor i diplomuar i arsimit fillor dhe profesor i arsimit fillor në gjuhën frënge. Ka nostrifikimin e diplomës së arsimit të lartë nr. /// e /// viti,

lëshuar nga ministria e përmendur më parë, e cila fitoi të gjitha të drejtat për punësim në RMV mbi atë bazë.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: G.T.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

